



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 367/3 prot.

Tiranë, më 05.05.2026

V E N D I M

PARALAJMËRIMI

Nr. 48, datë 05.05.2026

**MBI VERIFIKIMIN E LIGJSHMËRISË SË ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT
CIVIL GJATË REALIZIMIT TË PROCEDURAVE TË VLERËSIMIT TË
REZULTATEVE NË PUNË TË NËPUNËSVE CIVILË NË INSTITUCIONIN E
BASHKISË BULQIZË DHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR TË
RREGULLUAR GJENDJEN E LIGJSHMËRISË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, si dhe në zbatim të Planit Vjetor të Punës së Komisionerit për vitin 2026, miratuar me Vendimin nr. 82, datë 31.12.2025, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me inspektimin e zhvilluar në institucionin e Bashkisë Bulqizë,

VËREJ SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe neneve 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, si dhe neneve 2, 14 germa a), 16, 19 pika 1 dhe 21 të Rregullores “Mbi Procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, të miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit, e ndryshuar; në zbatim të Planit Vjetor të Punës së Komisionerit për vitin 2026, miratuar me vendimin nr. 82, datë 31.12.2025, të Komisionerit, si dhe Urdhërit nr. 42, (nr. 367 prot.), datë 24.02.2026, “Për kryerjen e inspektimit të thelluar, në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil gjatë procesit të ndjekur për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë, në institucionin e Bashkisë Bulqizë”, ka filluar kryesisht inspektimin për zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, si dhe veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe

subjektet/mekanizmat e tjera të ngarkuara me detyra specifike gjatë procesit të vlerësimit të nëpunësve civilë, në institucionin e Bashkisë Bulqizë.

Mënyra e funksionimit të njësive të vetëqeverisjes vendore, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse, janë të rregulluara me ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”. Sipas këtij ligji, njësitë e vetëqeverisjes vendore, janë bashkitë dhe qarqet, të cilat realizojnë vetëqeverisjen vendore në Republikën e Shqipërisë.

Në nenin 6 dhe 65 të këtij ligji, përcaktohet se: “*Bashkia përbëhet nga disa njësi administrative, sipas lidhjeve tradicionale, historike, ekonomike dhe sociale. Njësitë administrative në territorin e një bashkie, shtrirja e tyre territoriale dhe emri, përcaktohen me ligj*”;

“*Struktura dhe organika e administratës së njësive administrative janë pjesë të strukturës dhe organikës së administratës së bashkisë*”.

Bashkia, si organ i vetëqeverisjes vendore, ka hyrë në skemën e administrimit të shërbimit civil me ligjin nr. 8549/1999, “*Statusi i nëpunësit civil*” (i shfuqizuar) dhe ka ruajtur të njëjtin status edhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, pasi në nenin 2 të tij, përcaktohet se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, organet e qeverisjes vendore janë riorganizuar. Konkretisht, në nenin 54 të ligjit, ku parashikohen detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak, në germën dh), përcaktohet se, **këshilli bashkiak** miraton buxhetin dhe numrin maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë.

Ndërsa në nenin 64 të këtij akti ligjor, ku parashikohen detyrat dhe kompetencat e kryetarit të bashkisë, në germën j), përcaktohet se, **kryetari i bashkisë**, miraton strukturën, organikën e kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njësive e institucioneve në varësi të bashkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Bashkia Bulqizë është e organizuar dhe funksionon në bazë të strukturës dhe organikës së miratuar me Urdhrin nr. 05, (nr. 28 prot.), datë 06.01.2025, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, “*Për miratimin e strukturës së nëpunësve civil dhe punonjësve administrative të Bashkisë Bulqizë dhe të institucioneve në varësi të saj*”.

I. Metodologjia e përdorur për sistemimin e informacionit të mbledhur, në përputhje me objektin e inspektimit.

Objekti i inspektimit përfshin kontrollin dhe vlerësimin e veprimeve administrative të kryera nga nëpunësit përgjegjës të ngarkuar me detyra specifike në vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë të institucionit të Bashkisë Bulqizë, për vlerësimet e fundit që përkojnë me periudhën Korrik – Dhjetor, viti 2025.

Grupi i punës ka zgjedhur si metodë pune verifikimin në vend të të gjitha akteve administrative të përmendura më sipër, si dhe të çdo dokumenti tjetër të domosdoshëm për realizimin e objektit të inspektimit. Ky dokumentacion administrohet në arkivin e institucionit, si dhe në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Të dhënat/gjetjet e konstatuara në lidhje me mënyrën e administrimit të procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, nga institucioni i inspektuar janë të materializuara në Tabelën nr. 1, “Procedura e ndjekur nga zyrtarët e autorizuar nga ligji gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civile” dhe Tabelën nr. 2 “Niveli i vlerësimit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025, në raport me kategoritë e vlerësimit” si dhe procesverbalet e inspektimit të hartuara nga grupi punës, të cilat janë pjesë e këtij vendimi.

II. Situata e administrimit të burimeve njerëzore në momentin e inspektimit

Në momentin e inspektimit, institucioni i Bashkisë Bulqizë funksionon mbi bazën e strukturës organizative të miratuar me Urdhrin nr. 16 (nr. 101 prot.), datë 10.01.2025, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Bulqizë dhe institucioneve në varësi bazuar në numrin maksimal dhe kategorinë e pagave të miratuara nga Këshilli Bashkiak për vitin 2025”, i ndryshuar.

Nga analiza e strukturës që është në fuqi në momentin e inspektimit, rezulton se, institucioni i mbikëqyrur ka gjithsej **299** pozicione pune të miratuara për aparatën e bashkisë dhe njësitë administrative që janë (*Martanesh, Fushë-Bulqizë, Zerqan, Shupenzë, Gjoricë, Ostren, dhe Trebisht*). Rezulton se struktura dhe organika e këtyre njësive administrative është përfshirë në strukturën dhe organikën e administratës qendrore të Bashkisë Bulqizë. Bazuar në funksionet që ato kryejnë, situata paraqitet si më poshtë:

- **3** pozicione pune, **funksionarë** politik, (*Kryetar dhe 2 Nënkryetarë*);
- **13** pozicione pune, funksionarë kabineti, (*Drejtor Kabineti, Këshilltar Sekretar i Këshillit Bashkiak dhe Administratorë*);
- **206** pozicione pune, punonjës administrativë, (*punonjës shërbimi, mirëmbajtës, pastrimi etj.*), të cilët kryejnë funksione jashtë shërbimit civil, për të cilët marrëdhënia juridike e punës rregullohet sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e Punës dhe ligjet organike;
- **77 pozicione pune janë pjesë e shërbimit civil.**

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve të shërbimit civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, **77 pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil** në administratën e Bashkisë Bulqizë, paraqiten në këtë raport:

- Nëpunës civilë të kategorisë së lartë drejtuese - 1 pozicion pune (ose 1%), që i përket pozicionit të punës “Sekretar i Përgjithshëm”;
- Nëpunës civilë të kategorisë së mesme drejtuese - 9 pozicione pune (ose 12%), të cilat i përkasin pozicionit “Drejtor Drejtorie”;
- Nëpunës civilë të kategorisë së ulët drejtuese - 18 pozicione pune (ose 23%), të cilat i përkasin pozicionit “Përgjegjës Sektori”;
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive - 49 pozicione pune (ose 64%), të cilat i përkasin pozicionit “Specialist”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e personelit të krijuar për çdo nëpunës, vënë në dispozicion grupit të punës nga njësia e burimeve njerëzore, e cila administron çdo të dhënë në lidhje me aspektet e zhvillimit/menaxhimit të marrëdhënies së punës në institucion, rezulton se, mënyra e plotësimit të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil në Bashkinë Bulqizë, paraqitet si më poshtë:

- ✓ **12 pozicione** pune, janë plotësuar nëpërmjet procedurave të konkurrimit të përcaktuara nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- ✓ **61 pozicione** pune janë të plotësuara në kundërshtim me ligjin, me akt të përkohshëm emërimi nga titullari i institucionit;
- ✓ **4 pozicione** pune janë aktualisht të lira.

Konkretisht, **61 pozicione të shërbimit civil** të plotësuara me punonjës të emëruar në kundërshtim me ligjin, paraqiten si më poshtë:

1. Gerta Jella, emëruar me aktin nr. 63 prot., datë 20.03.2024, “Komandim në pozicion pune”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”;
2. Belina Toska, emëruar me aktin nr. 29 prot., datë 12.01.2023, “Komandim në pozicion pune”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Përgjegjës”, pranë Sektorit të Auditit të Brendshëm;
3. Erjola Budini, emëruar me aktin nr. 84 prot., datë 26.04.2024, “Transferim në pozicion pune”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Auditit të Brendshëm;
4. Eva Koltraka, emëruar me aktin nr. 61 prot., datë 12.03.2024, “Komandimi emërim provizor, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Koordinatorë”, pranë Sektorit të Integritit Europian dhe Ndihmës së Huaj;
5. Valerja Gjokolaj, emëruar me aktin nr. 205 prot., datë 18.07.2023, “Emërim provizor, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist i Koordinimit dhe Donatorëve”, pranë Sektorit të Integritit Europian dhe Ndihmës së Huaj;
6. Shkëlqim Dema, emëruar me aktin nr. 224 prot., datë 01.09.2025, “Për transferimin të përkohshëm në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Drejtor”, pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse;
7. Florinda Capa, emëruar me aktin nr. 80 prot., datë 16.04.2024, “Komandim në pozicion pune”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Përgjegjës”,

- pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse;
8. Rudina Manjani, emëruar me aktin nr. 20 prot., datë 11.01.2023, “Për emërim provizor”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse;
 9. Zhuljeta Deda, emëruar me aktin nr. 308 prot., datë 02.10.2023, “Komandim në pozicion pune”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Përgjegjës”, pranë Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike;
 10. Argita Llani, emëruar me aktin nr. 351 prot., datë 24.10.2023, “Komandim në pozicion pune”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike;
 11. Xhesika Lusha, emëruar me aktin nr. 352 prot., datë 24.10.2023, “Komandim në pozicion pune”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike;
 12. Afërdita Kurti, emëruar me aktin nr. 421 prot., datë 12.12.2022, “Për emërim provizor”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Kontabilitetit dhe Aseteve;
 13. Matilda Isaku, emëruar me aktin nr. 158 prot., datë 01.07.2024, “Për emërim në punë”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Përgjegjës”, pranë Sektorit të Monitorimit dhe Zbatimit të Buxhetit;
 14. Eneida Lazri, emëruar me aktin nr. 36 prot., datë 03.02.2022, “Për emërim të përkohshëm në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Monitorimit dhe Zbatimit të Buxhetit;
 15. Beklie Meta, emëruar me aktin nr. 24 prot., datë 24.01.2025, “Emërim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Monitorimit dhe Zbatimit të Buxhetit;
 16. Ndriçim Cami, emëruar me aktin nr. 202 prot., datë 30.07.2025, “Lirimin nga pozicioni i Administratorit të Njësisë Administrative Gjorice”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Përgjegjës”, pranë Sektorit të Taksave dhe Kontrollit në Terren;
 17. Ermalda Balja, emëruar me aktin nr. 122 prot., datë 11.09.2019, “Për emërim të përkohshëm në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist i regjistrimit dhe vlerësimit të objekteve”, pranë Sektorit të Taksave dhe Kontrollit në Terren;
 18. Abdi Hasmeta, emëruar me aktin nr. 130 prot., datë 15.04.2022, “Emërim Provizor”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist i regjistrimit dhe vlerësimit të objekteve”, pranë Sektorit të Taksave dhe Kontrollit në Terren;
 19. Avni Sula, emëruar me aktin nr. 27/20 prot., datë 30.01.2025, “Për transferimin e përhershëm për shkak të ristrukturimit”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist i regjistrimit dhe vlerësimit të objekteve”, pranë Sektorit të Taksave dhe Kontrollit në Terren;
 20. Zeni Isaku, emëruar me aktin nr. 05 prot., datë 10.01.2021, “Për emërim të përkohshëm në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin

- “Specialist i regjistrimit dhe vlerësimit të objekteve”, pranë Sektorit të Taksave dhe Kontrollit në Terren;
21. Aishe Tufa, emëruar me aktin nr. 171 prot., datë 09.07.2024, “Transferim në pozicion pune”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist Turizmi”, pranë Sektorit të Turizimit dhe Monumenteve të Kulturës;
 22. Korab Kika, emëruar me aktin nr. 210 prot., datë 11.08.2025, “Për transferimin të Përkohshëm në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Drejtör”, pranë Drejtorisë së Kujdesit Social;
 23. Klajdjola Hoxha, emëruar me aktin nr. 309 prot., datë 02.10.2023, “Komandim në pozicion pune”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Përgjegjës”, pranë Sektorit të Ndhmës Ekonomike në Bashki;
 24. Majlinda Laçi, emëruar me aktin nr. 37 prot., datë 12.02.2021, “Për transferim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Ndhmës Ekonomike në Bashki;
 25. Emirjana Pepa, emëruar me aktin nr. 340 prot., datë 23.10.2023, “Transferim në pozicion pune”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Ndhmës Ekonomike në Bashki;
 26. Agron Boja, emëruar me aktin nr. 27/50 prot., datë 30.01.2025, “Transferim e përhershëm për shkak të ristrukturimit”, të Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Ndhmës Ekonomike në Bashki;
 27. Mariglen Imeri, emëruar me aktin nr. 270 prot., datë 04.08.2024, “Për emërim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Ndhmës Ekonomike në Bashki;
 28. Emrie Cami, emëruar me aktin nr. 119 prot., datë 31.03.2023, “Komandim në pozicion pune”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Përgjegjës”, pranë Sektorit të Ndhmës Ekonomike në Njësitë Administrative;
 29. Natasha Kazani, emëruar me aktin nr. 81 prot., datë 08.01.2016, “Për emërim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Ndhmës Ekonomike në Njësitë Administrative;
 30. Endrit Uka, emëruar me aktin nr. 231 prot., datë 01.08.2023, “Komandim në pozicion pune”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Përgjegjës”, pranë Sektorit të PAK, (Persona me Aftësi të Kufizuara);
 31. Albin Bodini, emëruar me aktin nr. 225 prot., datë 01.09.2025, “Për transferim të përkohshëm në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Drejtör”, pranë Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronave;
 32. Benard Saraçi, emëruar me aktin nr. 27/28 prot., datë 30.01.2025, “Për transferimin e përhershëm për shkak të ristrukturimit”, të Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Zhvillimit të Territorit dhe Mjedisit;
 33. Jona Halili, emëruar me aktin nr. 27/26 prot., datë 30.01.2025, “Për transferimin e përhershëm për shkak të ristrukturimit”, të Sekretarit të Përgjithshëm, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Zhvillimit të Territorit dhe Mjedisit;

34. Vaide Bala, emëruar me aktin nr. 126 prot., datë 12.04.2022, “Për transferimin në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Përgjegjës”, pranë Sektorit të Planifikimit të Territorit;
35. Klorenc Disha, emëruar me aktin nr. 254 prot., datë 06.10.2025, “Për transferimin në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Përgjegjës”, pranë Sektorit të Planifikimit të Territorit;
36. Mustafa Mira, emëruar me aktin nr. 251 prot., datë 04.09.2023, “Komandim në pozicion pune”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Planifikimit të Territorit;
37. Ulvi Hysa, emëruar me aktin nr. 28 prot., datë 02.02.2022, “Për transferimin në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Përgjegjës”, pranë Sektorit të Pronave;
38. Edison Laçi, emëruar me aktin nr. 350 prot., datë 24.10.2023, “Transferim në pozicion pune”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Pronave;
39. Marsida Murja, emëruar me aktin nr. 45 prot., datë 26.02.2024, “Komandim në pozicion pune”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Drejtor”, pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Arsimit, Trashëgimisë, Rinisë dhe Sporteve;
40. Andi Topi, emëruar me aktin nr. 403 prot., datë 05.12.2023, “Për emërim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Arsimit, Rinisë, Sporteve dhe Komunikimit;
41. Defrim Karaj, emëruar me aktin nr. 161 prot., datë 09.10.2019, “Për emërim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Arsimit, Rinisë, Sporteve dhe Komunikimit;
42. Rozeta Pepa, emëruar me aktin nr. 323 prot., datë 10.10.2023, “Komandim në pozicion pune”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Arsimit, Rinisë, Sporteve dhe Komunikimit;
43. Alkida Daci, emëruar me aktin nr. 262 prot., datë 11.09.2023, “Komandim emërim provizor”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Arsimit, Rinisë, Sporteve dhe Komunikimit;
44. Shahin Alliu, emëruar me aktin nr. 213 prot., datë 15.08.2025, “Për transferim të përkohshëm në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Drejtor”, pranë Drejtorisë së Zhvillimit Rural;
45. Bledar Lleshi, emëruar me aktin nr. 109 prot., datë 21.05.2024, “Komandim në pozicion pune”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Përgjegjës”, pranë Sektorit të Bujqësisë dhe Veterinarisë;
46. Flutura Xhafa, emëruar me aktin nr. 57 prot., datë 03.02.2023, “Emërim në pozicion pune”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Bujqësisë dhe Veterinarisë;
47. Anxhela Balla, emëruar me aktin nr. 146 prot., datë 15.05.2023, “Emërim provizor”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Bujqësisë dhe Veterinarisë;
48. Jurgen Jella, emëruar me aktin nr. 367 prot., datë 16.11.2022, “Emërim me kontratë provizore”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Bujqësisë dhe Veterinarisë;

49. Mehmet Karaj, emëruar me aktin nr. 17 prot., datë 08.01.2016, “Për emërim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Bujqësisë dhe Veterinarisë;
50. Erion Hajdari, emëruar me aktin nr. 339 prot., datë 23.10.2023, “Komandim në pozicion pune”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Bujqësisë dhe Veterinarisë;
51. Besnik Kenga, emëruar me aktin nr. 78 prot., datë 08.01.2016, “Për emërim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Bujqësisë dhe Veterinarisë;
52. Genci Velia, emëruar me aktin nr. 47 prot., datë 11.01.2023, “Komandim në pozicion pune”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Përgjegjës”, pranë Sektorit të Mbrojtjes së Konsumatorit;
53. Agim Tuçi, emëruar me aktin nr. 213 prot., datë 02.12.2019, “Për emërim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Mbrojtjes së Konsumatorit;
54. Zuriye Osmani, emëruar me aktin nr. 141 prot., datë 04.05.2023, “Emërim provizor”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Mbrojtjes së Konsumatorit;
55. Shaqir Izvira, emëruar me aktin nr. 65 prot., datë 02.04.2024, “Komandim në pozicion pune”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Drejtor”, pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Kullotave;
56. Arben Mera, emëruar me aktin nr. 47/1 prot., datë 01.03.2021, “Për emërim dhe transferim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Përgjegjës”, pranë Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave;
57. Besnik Cukali, emëruar me aktin nr. 49 prot., datë 16.04.2019, “Për emërim të përkohshëm në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave;
58. Fitim Balla, emëruar me aktin nr. 89 prot., datë 09.05.2024, “Komandim në pozicion pune”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave;
59. Erbblind Pepa, emëruar me aktin nr. 47/1 prot., datë 01.03.2021, “Për emërim dhe transferim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave;
60. Adhurim Shyti, emëruar me aktin nr. 242 prot., datë 17.09.2025, “Për emërim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Specialist”, pranë Sektorit të Pronave;
61. Ina Koçi, emëruar me aktin nr. 201 prot., datë 30.07.2025, “Lirimin nga pozicioni i përgjegjës së Sektorit të Taksave dhe Kontrrollit në terren”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “Përgjegjës”, pranë Sektorit të Pronave.

Për këta punonjës nuk është kryer procesi i vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën objekt kontrolli.

Sa i përket akteve të emërimit të këtyre punonjësve, ato do të jenë objekt verifikimi nga Komisioneri në proceset e ardhshme.

Ndërkohë për këtë periudhë vlerësimi ka përfunduar marrëdhënia e punësimit për punonjësit si më poshtë:

1. Maliq Mera, përfunduar marrëdhënia e punës me aktin nr. 227 prot., datë 08.09.2025, “Mbi përfundimin e marrëdhënieve të punës”, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin “*Specialist*”, pranë Sektorit të Pronave, pozicion në të cilin është emëruar më pas me akt të thjeshtë emërimi, punonjësi Adhurim Shyti;
2. Mehmet Gjoka, përfunduar marrëdhënia e punës me aktin nr. 228 prot., datë 08.09.2025, “Mbi përfundimin e marrëdhënieve të punës”, në pozicionin “*Specialist*”, pranë Sektorit të Bujqësisë dhe Veterinarisë, pozicion i cili rezulton të jetë vakant.

IV. Përcaktimi i linjës së Zyrtarëve vlerësues në institucionin e Bashkisë Bulqizë

Nisur nga përkufizimi i Zyrtarëve vlerësues, në Vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, kreu I, “Të përgjithshme”, ku parashikohet se, “...b) “Zyrtar Raportues”, nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën e hierarkisë organizative nëpunësin që do të vlerësohet; c) “Zyrtar Kundërfirmues”, nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën hierarkike Zyrtarin Raportues; ç) “Zyrtar Autorizues”, nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën e hierarkisë Zyrtarin Kundërfirmues..., në rolin e Zyrtarëve vlerësues në këtë institucion paraqiten:

- **Kryetari i Bashkisë**, paraqitet në rolin e Zyrtarit Autorizues/Kundërfirmues/Raportues, për vlerësimin e nëpunësit në pozicionin e punës Sekretar i Përgjithshëm; Zyrtar Autorizues/Kundërfirmues, për pozicionin e punës Drejtor Drejtorie dhe Zyrtar Autorizues për vlerësimin e nëpunësit në pozicionin e punës Përgjegjës Sektori;
- Nëpunësi i punësuar në pozicionin e punës **Sekretar i Përgjithshëm (1 pozicion pune)**, paraqitet në rolin e Zyrtarit Raportues për vlerësimin e nëpunësit në pozicionin e punës Drejtor Drejtorie, në rolin e Zyrtarit Kundërfirmues për vlerësimin e nëpunësit në pozicionin e punës Përgjegjës Sektori dhe në rolin e Zyrtarit Autorizues për vlerësimin e nëpunësit në pozicionin Specialist.
- Nëpunësi i punësuar në pozicionin **Drejtor Drejtorie (9 pozicione pune)**, paraqiten në rolin e Zyrtarit Raportues, për nëpunësit e punësuar në pozicionet Përgjegjës Sektori, në njësinë organizative që ata drejtojnë dhe në rolin e Zyrtarit Kundërfirmues për vlerësimin e nëpunësit në pozicionin Specialist.
- Nëpunësi i punësuar në pozicionin **Përgjegjës Sektori (18 pozicione pune)**, paraqitet në rolin e Zyrtarit Raportues për vlerësimin e nëpunësit në pozicionin e punës Specialist (49 pozicione).

Evidentojmë faktin se, sipas përcaktimeve në nenin 4, pika 1, germa f), të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, për institucionet e vetëqeverisjes vendore, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, pranë bashkisë, paraqitet si njësi përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil të institucionit.

Bazuar në strukturën dhe organikën që është në fuqi në momentin e kryerjes së inspektimit, Bashkia Bulqizë ka **77** pozicione pjesë e shërbimit civil, nga të cilat, **73** pozicione pune janë të plotësuara dhe **4** pozicione pune janë vakante.

Institucioni i Bashkisë Bulqizë është institucion i vetëqeverisjes vendore, e për këtë arsye, kategoritë dhe klasat e zbatueshme për pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, në këtë institucion, parashikohen në Vendimin nr. 503, datë 01.08.2024, të Këshillit të Ministrave, *“Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”*, i cili i grupon në bazë të numrit të banorëve, akt të cilit i është referuar njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në përcaktimin e pagave në institucion.

Gjithashtu, rezulton se, numri i punonjësve për çdo njësi organizative është brenda kufirit të miratuar me ligjin për administratën shtetërore dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 893, datë 17.12.2014, *“Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”*, i ndryshuar, akt të cilit institucionet e vetëqeverisjes vendore i referohen për analogji.

V. Verifikimi i ligjshmërisë së procedurave të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë

Ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore në zbatim të tij i ngarkojnë nëpunësit e punësuar në kategoritë drejtuese të shërbimit civil Përgjegjës Sektori; Drejtor Drejtorie; Drejtor Drejtorie të Përgjithshme/Sekretar i Përgjithshëm dhe Titullarin e institucionit; me detyra specifike në administrimin e shërbimit civil.

Një nga këto detyra është realizimi i procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë. Kjo kërkesë buron nga neni 62, i ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Vlerësimi i rezultateve në punë është procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive ose dobësive të nëpunësve në kryerjen e detyrave, që realizohet çdo 6 muaj”*.

Më tej, është miratuar Vendimi nr. 109, datë 26.02.2014, i Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar, ku janë përcaktuar në mënyrë të hollësishme se cilët janë nëpunësit përgjegjës për realizimin e procedurës së

vlerësimit; fazat dhe afatin kohor brenda të cilit duhet të kryhen procedurat për të vlerësuar nivelin e realizimit të objektivave të vendosura; vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit; detyrat e zyrtarëve të përfshirë në procesin e vlerësimit; nivelet e shkallëzuara të vlerësimit, si dhe të drejtat e nëpunësit në rastet kur ai nuk është dakord me vlerësimin përfundimtar.

Në kuptim të dispozitave ligjore si më sipër, në pikën 2, të kreut II, të VKM-së nr. 109, datë 26.02.2014, i ndryshuar, përcaktohet se, vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civilë të konfirmuar është një proces që duhet të realizohet çdo 6 muaj, brenda vitit kalendarik. Ndërsa për nëpunësit civilë në periudhë prove, periudha e vlerësimit është vjetore dhe llogaritet nga data e emërimit në detyrë të nëpunësit civil. Më tej, në germën c), pika 12, të këtij kreu, janë parashikuar afatet e realizimit të këtij procesi. Sipas kësaj dispozite nënligjore, vlerësimi përfundimtar për secilën periudhë vlerësimi realizohet përkatësisht në periudhën 1 - 15 Korrik dhe 1 – 15 Janar të çdo viti.

V.1. Fazat e vlerësimit në raport me kërkesat e ligjit

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të inspektimit, grupi i inspektimit i kërkoj njësisë së burimeve njerëzore të subjektit, që t'i vinte në dispozicion dosjet me materialet shkresore të vlerësimit, të cilat provojnë realizimin e të gjitha fazave të këtij procesi të parashikuara në pikën 12, kreu II, i VKM-së nr. 109, datë 26.02.2014, "*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*", i ndryshuar, që janë:

- Planifikimi, ku Zyrtari Raportues, përcakton objektivat kryesorë të punës dhe sjelljet përkatëse profesionale që bëjnë të mundur realizimin e planit të punës, përmbushjen e objektivave dhe të misionit të institucionit. Në fazën e planifikimit përfshihet përgatitja e objektivave dhe e një plani veprimtarish për arritjen e objektivave kryesore. Objektivat kryesorë të punës duhet të jenë të matshëm, kurse veprimet të dukshme. Në këtë fazë Zyrtari Raportues dhe nëpunësi që do të vlerësohet diskutojnë së bashku qëllimet e nëpunësit për karrierë, aspiratat dhe çdo gjë tjetër që lidhet me trajnimin dhe zhvillimin profesional.
- Bisedimet e ndërmjetme. Në mes të periudhës së vlerësimit, Zyrtarët Raportues takohen me secilin prej nëpunësve që do të vlerësohet për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të planifikuara për të shprehur mendime dhe për të dhënë komente, si dhe për të bërë përmirësimet e nevojshme në planin e hartuar me shkrim.
- Vlerësimi përfundimtar, gjatë vlerësimit përfundimtar të rezultateve në punë, Zyrtari Raportues bën një vlerësim të përmbledhur të suksesit të nëpunësit që do të vlerësohet në arritjen e objektivave kryesore të punës, të përcaktuara në fazën e planifikimit dhe të rishikuar gjatë bisedimeve të ndërmjetme.

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe analiza e akteve të vlerësimit të punës, rezultoi se **nuk janë të dokumentuara** veprimet e kryera gjatë fazave të vlerësimit, të evidentuara më sipër.

Në lidhje me këtë aspekt, njësia e burimeve njerëzore sqaroi grupin e punës se, fazat e kërkuara gjatë procesit të vlerësimit janë zhvilluar vetëm verbalisht. Midis nëpunësit dhe Zyrtarit Raportues **nuk ka dosje individuale** (shënime, procesverbale, etj.), ku të jenë materializuar të gjitha fazat e vlerësimit, ndërsa “Formulari i Vlerësimit të Punës”, si i vetmi dokument që përmban të dhëna në lidhje me vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë, **është administruar** në dosjen e personelit të çdo nëpunësi, por në të nuk janë të reflektuara fazat e procesit.

Referuar aktit nënligjor në fjalë, në kreun II, “Sistemi i vlerësimit të rezultateve në punë”, pika 3, përcaktohet qartë se: “vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese kryhet bashkërisht nga Zyrtari Raportues, Zyrtari Kundërfirmues dhe Zyrtari Autorizues”, duke respektuar fazën e planifikimit, fazën e bisedimeve të ndërmjetme dhe fazën e vlerësimit përfundimtar.

Në lidhje me këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil, evidentojmë faktin se Zyrtarët e vlerësimit dhe njësia e burimeve njerëzore duhet të sigurojnë ecurinë normale të procedurës së vlerësimit. Sipas akteve rregullative të përmendura më sipër, Zyrtari Raportues vëzhgon mbarëvajtjen e punonjësit përgjatë gjithë periudhës së vlerësimit dhe mban shënime, që përmbajnë të dhëna mbi bazën e të cilave do të mbështetet vlerësimi. Njësia e burimeve njerëzore administron procesin duke bashkëpunuar me Zyrtarët e vlerësimit, me qëllim që procedura të realizohet në mënyrë korrekte, brenda afatit të kërkuar ligjor.

Nga verifikimi i formularëve të vlerësimit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse, pranë Bashkisë Bulqizë, për periudhën e vlerësimit Korrik - Dhjetor, viti 2025, u konstatua se, procedura e vlerësimit dhe respektimi i detyrimeve ligjore që ligji i ka vendosur aktorëve të këtij procesi, nga ana e Zyrtarit Raportues për secilin pozicion pune, **nuk është respektuar pasi nuk janë materializuar në akte në fillim të periudhës së vlerësimit** misioni dhe objektivat e pozicionit të punës, si dhe gjatë kësaj periudhe **nuk janë materializuar në akte bisedimet e ndërmjetme.**

Komente më të hollësishme në lidhje me mënyrën se si është plotësuar informacioni që kërkohet në ndarjet A, B, C, Ç, D dhe DH të formularit, si dhe nëndarjet e tyre; nëpunësit që kanë kryer detyrën e vlerësimit (Zyrtari Raportues/ Zyrtari Kundërfirmues/ Zyrtari Autorizues); nivelin e vlerësimit të përgjithshëm për çdo nëpunës; nënshkrimin nga Zyrtarët e vlerësimit si dhe dakordësinë/ kundërshtimin e vlerësimit nga nëpunësi i vlerësuar, janë paraqitur në tabelën nr. 1, “Procedura e ndjekur nga zyrtarët e autorizuar nga ligji gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, të hartuar nga grupi punës dhe që është pjesë e këtij vendimi.

Në vijim të analizës rezulton se, për periudhën e vlerësimit Korrik – Dhjetor, viti 2025, për **12** pozicionet e punës në shërbimin civil **janë hartuar** formularët e vlerësimit, (marrë kopje e njëhësuar për secilin pozicion sipas kategorive të nëpunësisë civile).

Gjithashtu, referuar dokumentacionit të administruar në dosjen personale të nëpunëses Olkeda Çupi, emëruar me aktin nr. 162/10, datë 01.07.2024, të njësisë së burimeve njerëzore, në pozicionin “*Specialist*”, në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse, konstatohet se periudha e provës për këtë nëpunëse ka përfunduar në datën 01.07.2025, është kryer vlerësimi i rezultateve individuale në punë pas përfundimit të periudhës së provës, si dhe është nxjerrë akti i deklaramit të statusit nga njësia përgjegjëse.

✓ **Përcaktimi i Zyrtarit Raportues dhe Zyrtarit Kundërfirmues, në vlerësimet e kryera për periudhën Korrik - Dhjetor, viti 2025**

Bazuar në parashikimet e Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar, përgjegjës për realizimin e procedurës së vlerësimit janë Zyrtari Raportues, Zyrtari Kundërfirmues dhe Zyrtari Autorizues, të cilët, bazuar në strukturën organizative të institucionit, paraqiten në linjën e eprorëve **që mbikëqyrin në mënyrë të drejtpërdrejtë** nëpunësin e vlerësuar.

Referuar strukturës organizative në bazë të së cilës është i organizuar dhe funksionon institucioni Bashkia Bulqizë, miratuar me Urdhrin nr. 05 (nr. 28 prot.), datë 06.01.2025, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, “*Për miratimin e strukturës së nëpunësve civil dhe punonjësve administrative të Bashkisë Bulqizë dhe të institucioneve në varësi të saj*”, linja e Zyrtarëve të vlerësimit për nëpunësit civilë të këtij institucioni paraqitet si më poshtë:

Vlerësimi i nëpunësve me emërtesën “*Specialist*”

Zyrtar Raportues	Përgjegjësi i Sektorit;
Zyrtar Kundërfirmues	Drejtori i Drejtorisë;
Zyrtar Autorizues	Sekretari i Përgjithshëm.

Vlerësimi i nëpunësve me emërtesën “*Përgjegjës Sektor*”

Zyrtar Raportues	Drejtori i Drejtorisë;
Zyrtar Kundërfirmues	Sekretari i Përgjithshëm;
Zyrtari Autorizues	Titullari i institucionit.

Vlerësimi i nëpunësit me emërtesën “*Sekretar i Përgjithshëm*”

Zyrtari Raportues	Titullari i institucionit;
Zyrtari Kundërfirmues	Titullari i institucionit;
Zyrtari Autorizues	Titullari i institucionit.

Në rastet kur pozicioni i Zyrtarit Raportues është vend vakant, autoriteti i tij (*kompetenca e vlerësimit*), në mënyrë të menjëhershme, i kalon Zyrtarit Kundërfirmues, i cili luan njëkohësisht edhe rolin e tij si Kundërfirmues, ndërsa në rastet kur mungon

Zyrtari Kundërfirmues, kompetenca e këtij të fundit i kalon Zyrtarit Autorizues dhe, kur për shkak të strukturës ky pozicion mungon, këtë cilësi e merr nëpunësi me pozicion më të lartë sipas linjës hierarkike të zyrtarit që do të zëvendësohet.

Referuar formularëve të vlerësimit për periudhën Korrik-Dhjetor, viti 2025, sikurse janë pasqyruar në tabelën nr. 1, “*Procedura e ndjekur nga zyrtarët e autorizuar nga ligji gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civile*”, që i bashkëlidhet këtij materiali, konstatohet se, linja e Zyrtarëve vlerësues të cilët kanë marrë pjesë në procesin e vlerësimit në një rast, **nuk ka qënë në përputhje** me kërkesat e parashikuara në VKM-në nr. 109, datë 26.02.2014, e ndryshuar, si dhe hierarkinë organizative që paraqitet në strukturën e institucionit, konkretisht, për nëpunësen Adela Jella, me detyrë “*Specialist*”, në Sektorin e Auditit të Brendshëm, janë hartuar dy formularë të pjesshëm vlerësimi, të cilët janë nënshkruar në rolin e Zyrtarit Raportues nga Përgjegjësi i sektorit, ndërkohë që, në rolin e Zyrtarit Kundërfirmues ka nënshkruar Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse, ndërsa, në rolin e Zyrtarit Autorizues paraqitet Sekretari i Përgjithshëm i institucionit.

Në këtë moment duhet të evidentojmë faktin se në rastin e sektorit të auditimit, paraqiten disa specifika në marrëdhënien e punës të cilat parashikohen në ligjin nr. 114/2015, “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”, i ndryshuar. Në nenin 10, pika 2 të këtij ligji, parashikohet shprehimisht se: “*Njësia e auditimit të brendshëm është e pavarur funksionalisht dhe raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek titullari i njësisë publike*”. Në këto kushte edhe linja e vlerësimit do të jetë e lidhur me titullarin e institucionit.

Sa më sipër, në rastin konkret rezulton se linja e Zyrtarëve vlerësues nuk është ndjekur në përputhje me kërkesat e ligjit specifik për auditimin, e për pasojë edhe të skemës organizative të paraqitur më lart. Në këtë rast edhe roli i **Zyrtarit Kundërfirmues dhe Autorizues i takon Titullarit të institucionit**.

- ✓ Në vijim të analizës së dokumentacionit të administruar, konstatohet se, për **7 (shtatë)** nëpunës, janë bërë dy vlerësime të pjesshme për periudhën Korrik-Dhjetor 2025, për shkak të ndryshimit të Zyrtarit Kundërfirmues, më konkretisht:

Për nëpunëset Enkeleda Rexhepi, Adela Murra, Erida Nela dhe Olkeda Çupi janë hartuar dy vlerësime të pjesshme pune për shkak të transferimit të Zyrtarit Kundërfirmues Korab Kika, me aktin nr. 210 prot., datë 11.08.2025, “*Për transferimin e përkohshëm në detyrë*”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, nga pozicioni “*Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse*” në pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë e Kujdesit Social*”. Ky nëpunës ka qënë në rolin e Zyrtarit Kundërfirmues për nëpunësit e sipërsënuar deri në datën 11.08.2025.

Në vijim, si Zyrtar Kundërfirmues për këto nëpunëse paraqitet punonjësi Shkëlqim Dema, emëruar me aktin nr. 224 prot., datë 01.09.2025, “*Për transferimin e përkohshëm në detyrë*”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin “*Drejtor*” në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

E njëjta situatë konstatohet edhe për dy nëpunësit e vlerësuar, Nexhmije Lleshi dhe Kalosh Murra, për të cilët gjithashtu janë hartuar dy formularë të pjesshëm pune (formulari i parë për periudhën 01.07.2025-11.08.2025 dhe formulari i dytë për periudhën 11.08.2025-31.12.2025), për shkak të ndryshimit të Zyrtarit Kundërfirmues. Bëhet fjalë për zyrtarin Vilson Sula, emëruar me aktin nr. 217, datë 26.08.2025, “Për emërim në pozicionin e nënkryetarit”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në pozicionin e “Nënkryetarit” të Bashkisë Bulqizë, i cili është zëvendësuar nga zyrtari Korab Kika, me aktin nr. 210 prot., datë 11.08.2025, “Për transferimin e përkohshëm në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë.

Ndërkohë, për nëpunësen Adela Jella, me detyrë “Specialist”, në Sektorin e Auditit të Brendshëm, konstatohet se janë hartuar dy formularë të pjesshëm vlerësimi, edhe pse nuk ka pasur ndryshim të Zyrtarëve vlerësues.

Konstatim: Në **7 raste** nëpunësit e evidentuar më lart, nga ana e zyrtarëve të përfshirë në procesin e vlerësimit janë hartuar dy formularë të pjesshëm të vlerësimit të rezultateve në punë, duke mos e finalizuar procesin e vlerësimit në një formular të vetëm.

Në këtë rast, sjellim në vëmendje të zyrtarëve vlerësues dhe njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore se, në përputhje me pikën 6 dhe 7, të kreut III, “Detyrat e nëpunësve të përfshirë në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë”, të VKM-së nr. 109, datë 26.02.2014, i ndryshuar, ku parashikohet se:

(pika 6) “... Në rast se gjatë periudhës së vlerësimit, zyrtarët që duhet të bëjnë vlerësimin largohen nga ai pozicion apo ndodhen në pamundësi të vazhdimit të detyrës, ata janë të detyruar të bëjnë vlerësimin për nëpunësin/nëpunësit për periudhën gjatë së cilës kanë ushtruar detyrën.

(pika 7) Vlerësimi sipas pikës 6 të këtij kreu, merret si bazë nga zyrtari zëvendësues në vlerësimin e tij përfundimtar”,

Zyrtarët vlerësues kanë detyrimin ligjor të bëjnë vlerësimin për nëpunësin/nëpunësit që mbikëqyrin në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën hierarkike, për të gjithë periudhën e ushtrimit të këtij funksioni. Në rast se, një nga zyrtarët largohet apo ndodhet në pamundësi të vazhdimit të mëtejshëm të detyrës, ai ka detyrimin ligjor të bëjë vlerësimin për nëpunësit nën hierarkinë e tij, për periudhën gjatë së cilës ka ushtruar detyrën. Ky vlerësim do të shërbejë si bazë nga zyrtari zëvendësues në vlerësimin e tij përfundimtar, i cili është një vlerësim i përmblodhur i suksesit të nëpunësit dhe duhet të përfshijë të gjithë periudhën e vlerësimit, duke përpiluar për këtë qëllim edhe një formular të vetëm vlerësimi të rezultateve në punë për punonjësin.

Më tej, zyrtari/zyrtarët që largohen gjatë periudhës së vlerësimit, duhet të dorëzojnë vlerësimin e pjesshëm pranë njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore, e cila më pas duhet ta vendosë atë, në dispozicion të zyrtarit i cili do të veprojë si zëvendësues i zyrtarit të larguar. Zyrtari që është në detyrë në fund të periudhës së vlerësimit, do të

bëjë vlerësimin përfundimtar të nëpunësit për të gjithë periudhën 6 mujore të vlerësimit, duke marrë parasysh të gjitha vlerësimet e pjeshme.

Në rastin konkret, konstatohet se subjekti i ngarkuar prej ligjit në rolin e Zyrtarit Raportues dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, në institucionin e Bashkisë Bulqizë, nuk e kanë finalizuar këtë proces vlerësimi, pasi rezultojnë të mos jetë hartuar dhe depozituar në dosjen e nëpunësve një formular i vetëm vlerësimi i rezultateve në punë, për periudhën 01.07.2025-31.12.2025, ku të pasqyrohen arritjet në punë të nëpunësve, për të gjithë periudhën e vlerësimit.

- ✓ *Gjatë këqyrjes së formularëve të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë të aparatit të Bashkisë Bulqizë, nuk u konstatua asnjë rast mosmarrëveshje midis zyrtarëve të përfshirë në procesin e vlerësimit, përsa i takon “nivelet” të vlerësimit.*
- ✓ *Sa i përket të dhënave që kërkohen në ndarjet/nëndarjet C) dhe Ç) të formularit të vlerësimit të punës konstatohet se, në të gjithë formularët e vlerësimit të rezultateve në punë, për periudhën Korrik – Dhjetor, viti 2025, në ndarjen C dhe ndarjen Ç të tij, rubrikat komente, janë plotësuar kryesisht me komentet standarte që përmban formulari.*
- ✓ *Në ndarjen D), gjatë plotësimit të formularëve të vlerësimit të punës, për periudhën Korrik - Dhjetor 2025, konstatohet se nuk është përdorur formati i përcaktuar në lidhjen nr.2, të VKM-së nr. 109, datë 26.02.2014, i ndryshuar, në rastin e nëpunësve të evidentuar si më poshtë:*
 - *Enkeleda Rexhepi, emëruar me aktin nr. 88 prot., datë 18.03.2022, “Për transferimin në detyrë”, të njësisë përgjegjëse, në pozicionin “Specialist”, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në formularët e vlerësimit të administruara për këtë nëpunës mungon plotësisht pjesa që lidhet me deklarin e dakordësisë ose jo të saj me vlerësimin, evidentohet vetëm nënshkrimi i nëpunëses.*
 - *Erida Nela, emëruar me aktin nr. 5421/5 prot., datë 12.12.2019 “Akt-Emërim”, të njësisë përgjegjëse, në pozicionin “Specialist”, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse, konstatohet se, në dy formularët e pjesëm të vlerësimit Zyrtari Kundërfirmues dhe Autorizues nuk kanë zgjedhur asnjë nga alternativat nëse janë ose jo dakord me vlerësimin.*
 - *Rustem Biçi, emëruar me aktin nr. 975 prot., datë 23.03.2016, “Akt-Emërim”, të njësisë përgjegjëse, në pozicionin “Drejtor”, konstatohet se mungon pika 4 e formularit, në të cilën Zyrtari Autorizues nënshkruan dhe deklaron nëse është dakord ose jo (nuk është fare pjesë e formularit të vlerësimit).*
 - *Beqir Halilja, emëruar me aktin nr. 122 prot., datë 10.08.2018 “Akt-Emërim”, të njësisë përgjegjëse, në pozicionin “Specialist i regjistrimit dhe vlerësimit të*

objekteve”, në Sektorin e Taksave dhe Kontrollit në Terren, konstatohet se ka mospërputhje në përcaktimin e Zyrtarit Raportues të paraqitur në ndarjet Ç) dhe D), pasi:

- në ndarjen Ç) ka nënshkruar në rolin e Zyrtarit Raportues punonjësi Ndriçim Cami,
- në ndarjen D) ka nënshkruar në rolin e Zyrtarit Raportues punonjësi Rakip Hoxha.

Duke ju referuar strukturës organizative në fuqi të Bashkisë Bulqizë, si Zyrtar Raportues për këtë nëpunës paraqitet punonjësi N. Cami, ndërsa punonjësi R. Hoxha duhet të paraqitet në rolin e Zyrtarit Kundërfirmues.

Sa më sipër, Komisionieri vë në dukje se plotësimi dhe nënshkrimi i të gjitha rubrikave të ndarjes D) të formularit të vlerësimit të punës, përbën një element thelbësor të procesit të vlerësimit, pasi në këtë ndarje Zyrtarët vlerësues dhe nëpunësi i vlerësuar shprehin dakordësinë lidhur me procesin e vlerësimit.

Në këtë kuadër, problematikav të tilla, duhet të konstatohen gjatë procesit nga njësia përgjegjëse, e cila ka detyrimin t’ia kthejë formularin për plotësim Zyrtarëve vlerësues dhe nëpunësit të vlerësuar, sipas rastit, dhe më pas ta administrojë atë në dosje, në përputhje me parashikimet e pikës 11, kreu VI, të VKM-së nr. 109, datë 26.02.2024, i ndryshuar.

Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë, duhet të jetë sipas formatit të kërkuar dhe i plotësuar me të gjithë elementët, sipas parashikimeve të këtij akti nënligjor. Mangësitë e konstatuara vihen në dukje për të evidentuar parregullsitë e nëpunësve të ngarkuar me detyra specifike prej ligjit, me qëllim për t’i plotësuar mangësitë e konstatuara në formularët e vlerësimit, si dhe për t’u patur parasysh në të ardhmen, që raste të tilla të mos përsëriten.

VI. Niveli i vlerësimit të nëpunësve civilë në raport me kategoritë e vlerësimit, për periudhën Korrik - Dhjetor 2025

Për të analizuar situatën e vlerësimit të nëpunësve civilë në këtë subjekt, në raport me 4 (*katër*) nivelet e vlerësimit, për periudhën objekt inspektimi, grupi i punës ka marrë si bazë të dhënash **12** rastet e vlerësimit të kryera në këtë institucion, duke patur parasysh nivelet e vlerësimit “*shumë mirë*”; “*mirë*”; “*kënaqshëm*” dhe “*jokënaqshëm*”, të parashikuar në pikën 13, kreu II, të VKM-së nr. 109, datë 26.02.2014, të ndryshuar.

Në vijim do të paraqitet vlerësimi përfundimtar i nëpunësve, sipas kategorive përkatëse të parashikuara në ligj dhe në aktin nënligjor:

Tabela nr. 2 Niveli i vlerësimit për gjashtëmuorin e dytë të vitit 2025, në raport me kategoritë e vlerësimit

Korrik - Dhjetor 2025				
<i>Niveli i vlerësimit përfundimtar</i>	<i>Shumë mirë(1)</i>	<i>Mirë(2)</i>	<i>Kënaqshëm(3)</i>	<i>Jo kënaqshëm(4)</i>
<i>Numri i nëpunësve të vlerësuar për çdo nivel vlerësimi</i>	7	5	0	0
Totali	12			

Sa më sipër, gjatë këtij procesi, është përdorur në 7 raste niveli i lartë i vlerësimit “Shumë mirë”; në 5 raste është aplikuar niveli “Mirë”, ndërsa nuk evidentohet asnjë rast të jetë përdorur niveli “Kënaqshëm” dhe “Jo kënaqshëm”. Nga analiza e këtyre të dhënave, rezulton se në këtë institucion nuk është përdorur i gjithë spektri i niveleve të vlerësimit. Shpërndarja e vlerësimit në dy nivelet “Mirë” dhe “Shumë mirë”, nuk krijon interes dhe motivim të nëpunësve për të kryer punën me një nivel gjithnjë e më të lartë cilësie, në kushtet kur të gjithë nëpunësit e institucionit vlerësohen në nivelet e larta.

Sa i takon mënyrës së vlerësimit, sfida e aktorëve të këtij procesi është përcaktimi i objektivave të qarta dhe të matshme, si dhe ndjekja e ecurisë së nëpunësve civilë nga ana e eprorit direkt, gjatë realizimit të objektivave dhe detyrave të tyre funksionale, me qëllim që vlerësimi i punës të vendoset në parametra sa më objektive dhe të përdoret i gjithë spektri i vlerësimit.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar,

V E N D O S A:

Të paralajmërojë institucionin e Bashkisë Bulqizë, për rregullimin e situatës së ligjshmërisë, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke vepruar në këtë mënyrë:

1. Zyrtarët vlerësues të cilët janë të ngarkuar me vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil të institucionit, duhet të plotësojnë në mënyrën e duhur, sipas orientimeve që janë dhënë në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, ndarjet dhe elementet formalë të kërkuara në formularin e vlerësimit në këto drejtime:

- Të plotësohen Formularët e vlerësimit me të dhënat që kërkohen në ndarjet e dallueshme A, B, C, Ç, D e DH, duke respektuar në mënyrë të përpiktë të gjitha udhëzimet e dhëna në kreun IV, të titulluar “*Formulari i vlerësimit*”, të VKM-së nr. 109, datë 26.02.2014, i ndryshuar dhe në udhëzimet e Komisionerit në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.
- Zyrtarët vlerësues të finalizojnë procesin e vlerësimit duke hartuar një formular të vetëm përfundimtar që përfshin të gjithë periudhën e vlerësimit për të gjitha vlerësimet e pjeshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në rastin e nëpunësve Enkeleda Rexhepi, Adela Murra, Erida Nela, Olkeda Çupi, Nexhmije Lleshi, Kalosh Murra dhe Adela Jella.
- Ndarja D, në formularët e vlerësimit të plotësohet dhe nënshkruhet nga Zyrtari Raportues/ Kundërfirmues/ Autorizues, si dhe nga nëpunësi i vlerësuar, sipas formatit të miratuar në lidhjen nr. 2, të VKM-së nr. 109, datë 26.02.2024, i ndryshuar.
- Nëpunësit e ngarkuar me detyrën e vlerësimit, duhet të bëjnë plotësime të natyrës teknike/materiale në formularët e vlerësimit të punës, me qëllim formalizimin dhe formatimin e tyre, si çdo dokument tjetër zyrtar.
- Zyrtari Raportues, duhet të marrë masat e duhura për realizimin e të gjitha fazave të procesit të rezultateve në punë të parashikuara në aktin nënligjor përkatës.
- Njësia e burimeve njerëzore e institucionit, të informojë zyrtarët e përfshirë në procedurën e vlerësimit të secilit punonjës, për periudhën e kërkuar, duke u kujdesur që zyrtarët pjesëmarrës në këtë proces, të veprojnë në përputhje me procedurat e hollësishme të përcaktuara në aktin nënligjor përkatës.
- Formulari i vlerësimit, të mos trajtohet si një akt formal që duhet të jetë i plotësuar me disa numra si nivele vlerësimi, por të jetë një dokument i hapur përgjatë gjithë periudhës së vlerësimit, ku të shënohen të gjitha arritjet dhe problematikat e nëpunësit civil, me qëllim për të arritur një vlerësim sa më objektiv të punonjësit.
- ✓ Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, pranë institucionit të Bashkisë Bulqizë, të ndjekë ecurinë e procesit administrativ, për realizimin e veprimeve të mësipërme, duke njoftuar aktorët e këtij procesi, për realizimin e detyrave konkrete.
- ✓ Të plotësohen formularët e vlerësimit në rubrikat përkatëse nga zyrtarët përkatës vlerësues dhe të nënshkruhen ato sipas parashikimeve ligjore.
- ✓ Në përfundim të këtij procesi, formulari i vlerësimit për çdo nëpunës civil të përfshihet në dosjen e personelit dhe Regjistrin Qendror të Personelit.

2. Zyrtarët e ngarkuar me procesin e vlerësimit, mund të njihen me përmbajtjen e këtij vendimi edhe nëpërmjet faqes zyrtare të Komisionerit, në adresën www.kmshc.al.
3. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **2 muaj** nga marrja dijëni për këtë vendim.
4. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, pranë institucionit të Bashkisë Bulqizë, të ndjekë ecurinë e proceseve administrative që duhet të kryhen për realizimin e veprimeve të përshkruara në këtë vendim, në funksion të zbatimit të tij brenda afatit të përcaktuar.
5. Me kalimin e këtij afati, subjekti i inspektuar, Bashkia Bulqizë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
6. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
7. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Bulqizë, duke i dërguar një kopje të vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)